



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 4 Mars 2022

Nr: 125

**VENDIM**

**PËR**

**KRIJIMIN E KQV-SË SË POSAÇME DHE SASINË E FLETËVE TË VOTIMIT PËR  
QENDRËN E POSAÇME TË VOTIMIT NR. 22241, NË KZAZ NR. 43, BASHKIA  
RROGOZHINË**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenin 43, nenin 62, pika 2, nenin 97, pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V Ë R E N:**

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 43, bashkia Rrogozhinë, me shkresën nr. 1495 prot., datë 3.3.2022 “Propozim për krijimin e KQV-së së posaçme”, i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, krijimin e Komisionit të Qendrës së Posaçme të Votimit nr. 22241. Nisur nga vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të marrë të gjitha masat për të siguruar të drejtën e votës të zgjedhësve të QV-së së posaçme nr. 22241, bashkia Rrogozhinë. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të autorizojë KZAZ-në nr. 43 që të krijojë komisionin e kësaj qendre votimi dhe të marrë masat për të siguruar fletët e votimit të QV nr. 22241 nga qendrat e tjera të votimit të ZAZ-së nr. 43, dhe për t’i dërguar në qendrën e votimit nr. 22241.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenin 97, pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,



## VENDOSI:

1. Të autorizojë KZAZ-në nr. 43, bashkia Rrogozhinë që me vendim, të krijojë dhe emërojë Komisionin e Qendrës së Posaçme të Votimit nr. 22241.
2. Të autorizojë KZAZ-në nr. 43, bashkia Rrogozhinë të marrë nga 20 (njëzet) fletë votimi nga QV nr. 2225, QV nr. 2226 dhe QV nr. 2226/1, dhe t'i dorëzojë në KQV-në nr. 22241. Në total do të merren 60 (gjashtëdhjetë) fletë votimi për të pajisur QV nr. 22241.
3. KZAZ nr. 43 të marrë masat që QV nr. 22241 të pajiset me fletët e votimit nga QV-të e cituara në pikën 2.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

